




Republika e Kosovës - Komuna e Suharekës
Republika Kosova- Opstine Suvareka
Republic of Kosovo-The Municipality of Suhareka




Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim

Nr-DATË/A:	07Nr. 625/350-61572-67745 datë: 22.11.2021
REFERENC-Ë:	07Nr.350-61572, datë: 01.10.2021 07Nr.350-67745 datë: 29.10.2021 --
PËR/TO:	Ukë Maliq Nrecaj, rruga " Shaban Mazreku"- Sopijë, Suharekë. Nr.Telefonit: 0 [REDACTED]
KOPJE/COPY:	Drejtorinë e Inspeksionit, Dosje të Drejtorisë
NGA/FROM:	Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim
	DREJTORI: Sanie KUQI REXHEPAJ Punoi: Sedat Bytyçi, inxh.dip.ndërt.
LËNDA/SUBJECT:	Aktvendim mbi Leje Ndërtimore

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim, ka pranuar kërkesën 07Nr.350-61572, datë: 01.10.2021 dhe 07Nr.350-61572 datë: 29.10.2021 nga Ukë Maliq Nrecaj nga fshati Sopijë e Suharekës, për Leje Ndërtimore për objektin afarist-market me etazhitet P+0 në parcelën kadastrale 00394-0, me numër referues të çertifikatës 1671/2021 datë 01.11.2021, Zona Kadastrale Sopijë, pronë e Ukë Maliq Nrecajt. Pas shqyrtimit të kërkesës ky organ vendos, si në Aktvendimin e bashkangjitur kësaj shkrese.

- **AKTVENDIM MBI LEJEN NDËRTIMORE**



Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim

Data: 22.11.2021

Numri i vrojtimit i lejes:

07Nr. 625/350-61572-
67745

Në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, Udhëzimit Administrativ Nr.08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, Ligjit për Procedurën Administrative Nr.05/L-031, Rregullores mbi Rregullat dhe Procedurat për Ndërtimin e Objekteve 01-Nr-16-423, datë 26.01.2011, neni 2, pika 2.2 dhe 2.4 të vendimit për aprovim të taksave administrative për lëshimin e lejes së ndërtimit për kategorinë e I-rë dhe të II-të, lejes së rrënit dhe tarifën rregullative për rritjen e densitetit të 2ates2tructures të Kuvendit të Komunës Suharekë: 01-Nr-016-21653, të 2ates: 29.03.2019 si dhe sipas Planit Zhvillimor Komunal 01Nr.5821 datë 05.03.2008, kërkesës dhe dokumenteve të paraqitura nga Ukë Maliq Nrecaj- Sopijë, Suharekë, Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim lëshon këtë :

AKTVENDIM
(MBI LEJE NDËRTIMORE)

Kjo leje ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	UKË MALIQ NRECAJ	Nr. Personal	
Adresa:	Rr." Shaban Mazreku ", Sopijë Suharekë	Telefoni:	
Email :	-	Kërkesa Bazë:	Aplikim për leje ndërtimore: 07Nr.350-61572, datë: 01.10.2021 dhe 07Nr.350- 67745, datë: 29.10.2021

Emri i Projektit:	OBJEKT- ME DESTINIM AFARIST MARKET		
Emri i Projektuesit:	" GURI-d.s" SH.P.K design studio Prishtinë		
Adresa:	Rr." Muharrem Fejza" p.n Lagjja e Spitalit , Prishtinë		
Telefoni:		Emaili:	

Për punët ndërtimore në vijim: NDËRTIM I RI			
Adresa: Rr." Shaban Mazreku", Sopijë SUHAREKË			
Zona(t) Kadastrale: Sopijë	Nr. i parcelës kadastrale:	Koordinatat e objektit-Shënimi(Piketimi):	
Sipas çertifikatës me nr. të lëndes : 1671/2021, datë 01.11.2021, Zona Kadastrale- Sopijë	00394-0	1 X = 7487120.569; 2 X = 7487129.860; 3 X = 7487133.101; 4 X = 7487140.719; 5 X = 7487150.573; 6 X = 7487132.203; 7 X = 7487125.655; 8 X = 7487127.117;	Y = 4688417.599 Y = 4688409.690 Y = 4688413.497 Y = 4688407.012 Y = 4688418.587 Y = 4688434.226 Y = 4688426.535 Y = 4688425.290

Lloji i ndërtimit të propozuar:			
Objekt-me destinim afarist-market			
Kategoria e ndërtimeve të propozuara:			
Kategoria II			
Sipërfaqja	Sipërfaqe bruto e objektit 398.5m ²	Katshmëria:	(P+0)
Vija rregullative	Nga aksi i rrugës" Shaban Mazreku" 7.0m' Nga aksi i rrugës" Muharrem Balia" 7.0m' Largësia përgjatë aksit të rrugës publike e ndryshueshme duke e përcjellur trajektorën me parametrat e lartëcekur në m'.	Vija ndërtimore	Sipas Aktvendimit mbi Kushtet ndërtimore: 07Nr.518/350-39987; dt.14.09.2021, Nga aksi i rrugës" Shaban Mazreku " 7.0m' Nga aksi i rrugës " Muharrem Balia " 7.0m'

Përshkrimi i lejës ndërtimore
Me këtë vendim, parashtuesit të kërkesës për leje ndërtimore <i>Ukë Maliq Nrecaj nga fshati Sopijsë – Suharekë</i> i lejohej ndërtimi i objektit afarist-market P+0. Lokacioni i objektit është në kuadër të PZHK-së, 01Nr.5821 datë 05.03.2008, ku sipas gjendjes së planifikuar, në parcelën kadastrale 00394-0, është tokë ndërtimore me destinim Tokë Ndërtimore. Objekti shtrihet në pjesën me destinim Tokë Ndërtimor. Objekti ka karakter të përhershëm me katshmëri (P+0). Ndërtimi i objektit të bëhet konform Kushteve Ndërtimore të lëshuara nga ky organ: 07Nr.518/350-39987, datë: 14.09.2021, si dhe projektit kryesor hartuar nga byroja projektuese: " GURI-d.s" SH.P.K design studio Prishtinë. Objekti është lejuar të ndërtohet me sipërfaqe bruto të objektit 398.5 m². Kjo leje ndërtimore lëshohet në bazë të aplikacionit dhe informatave mbështetëse. Ndërtimi do të bëhet në përputhje me dokumentet e aprovuara ndërtimore. Çfarëdo ndryshimi i projektit duhet të aprovohet nga hartuesi i projektit dhe nga ky organ. Poseduesi i Lejës Ndërtimore është i obliguar që: • Puna në ndërtim duhet të fillojë brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë së saj në pajtim me Ligjin. • Të vendos tabelën informuese në vendndërtim me informata e mëposhtme: - Informata mbi Lejën Ndërtimore; - Informata mbi Projektuesin; - Informata mbi Kontraktuesin; - Prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit. • Duhet të siguroheni se kontraktuesi në vendndërtim i posedon dokumentet e mëposhtme: - Një kopje të kësaj leje ndërtimore; - Nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë, një kopje e kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit; - Një kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të "APROVUAR" nga organi kompetent;

- Projektin Kryesor me të gjitha fazat për nevoja të realizimit të ndërtimit;
- Dokumentacioni që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, Kodin dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
- Librin dhe ditarine ndërtimit, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur;
- Protokolet e miratuara të nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit;
- Të dorëzojë njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
- Të njoftojë organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuata dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore.
- Të njoftojë organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga Projektuesi. Poseduesi i Lejës Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi përveq në rastet kur:
 - o Ndryshimet nuk janë në kundërshtim me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret në fuqi;
 - o Ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një(0.1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
 - o Ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, kodet dhe rregulloret teknike në fuqi;
- Nëse gjatë punimeve haset në elemente arkeologjike, investori është i obliguar ti ndërpresë punimet dhe të njoftojë organet komunale.
- Obligohet investori që gjatë gërmimit dhe ndërtimit të objektit të bëjë pastrimin e materialit të panevojshëm për punë dhe se të njejtin ta transportojë në deponinë për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore, në lokacionin e përcaktuar nga Kuvendi i Komunal.
- Pas përfundimit të punëve ndërtimore, të aplikojë për certifikatë të përdorimit në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore.

A r s y e t i m

Aplikuesi Ukë Maliq Nrecaj nga fshati Sopiçë e Suharekë, përmes kërkesës 07Nr.350-61572, datë: 01.10.2021 dhe 07Nr.350-61572 datë: 01.10.2021, ka kërkuar nga organi kompetent lëshimin e Lejës Ndërtimore për ndërtim të objektit afarist-market, sipas projektit të bashkangjitur.

Kjo leje ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Aktvendimi mbi Kushtet Ndërtimore 07Nr.518/350-39987, datë: 14.09.2021.
- Leje Mjedisore Komunale 03Nr. 520/181-67738, datë 09.11.2021.
- Pëlqim për largimin e mbeturinave Nr.139/21, të datës: 20.10.2021, lëshuar nga NPRM “ECO-REGJIONI”- Prizren, Njësia operative Suharekë.
- Dëshmi për pagesën e taksës administrative për Leje Ndërtimore sipas njoftimit 07Nr. 614/350-61572-67745, datë: 17.11.2021, në shumë prej: 1,115.8€, e paguar në ProCredit Bank
- Prishtinë, 564651076, datë: 18.11.2021, sipas faturës komunale nr.000768, datë: 17.11.2021.
- Pëlqim për kyqje në rrjetin publik të Ujësjellësit dhe Kanalizimit –Hidroregjioni Jugor Prizren

Nr.205, datë: 23.09.2021.

- Pëlqim për kushtet e sigurisë në komunikacion rrugor – nga Inspektori i Komunikacionit Rrugor 09 Nr.2660, datë: 04.11.2021.
- Pëlqim elektroenergjetik, KEDS-SH.A, Nr.8405, datë: 31.08.2021.
- Pëlqim për mbrojtje nga zjarri Nr.03/03-101, datë 20.10.2021.
- Pëlqim sanitaro-higjenik 09Nr.2661, datë 04.11.2021
- Koordinatat e objektit të vendosura sipas kushteve ndërtimore nga gjeodeti i licencuar Zekirja Elezi me Nr. të licencës 17.
- Elaboratin për menaxhimin e ujrave sipërfaqësor.
- Tri kopje të projektit zbatues dhe kopje elektronike CD.
- Kopje e planit dhe çertifikata e pronësisë.
- Vërtetimin e tatimit në Pronë.
- Kopje e dokumentit Identifikues.

Ky organ përmes shërbimit të vet profesional pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumenteve tjera përcjellëse, bazuar në Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim, konform PZHU-së 01Nr.5820 datë 05.03.2008, ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv.


Udhëzim juridik: Kundër kësaj Leje Ndërtimore pala e pakënaqur mund t'i paraqitet ankesë MMPHI në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e dorëzimit përmes këtij Organi.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim – Komuna Suharekë
Numri i vrojtimit i lejes 07Nr. 625/350-61572-67745 datë: 22.11.2021

Vendimi i dërgohet:

-Parashtruesit të kërkesës;
Inspektoratit të Komunës;
Dosjes së DUP-së

Drejtori i Drejtorisë:
Sanije KUQI REXHEPAJ



Faqe5nga5